

INAUGURIMI I BIBLIOTEKËS NË LUSHNJË

Më datë 25 Tetor, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët mori pjesë në **inaugurimin e bibliotekës në Lushnje, rikonstruktuar me mbështetjen e Agjencisë Kombëtare të Rinisë nga thirrja e dytë për projekt-propozime rinore**. Të rinjtë e qytetit të Lushnjes tashmë kanë një ambient të dedikuar për të kaluar kohë cilësore, me **më shumë se tetëdhjetë e tre mijë libra për të zgjeruar njohuritë e tyre**, e mbi të gjitha një hapësirë moderne dedikuar nevojave të tyre për të studiuar në një ambient të përbashkët, me qëllim rritjen e ndërveprimit midis të rinjve, produktivitetit të tyre dhe rritjen e të nxënësve produktiv.



PANAIR PËR EDUKIM, TRAJNIM DHE PUNËSIM NË VLORË, SHKODËR, TIRANË

Në kuadër të nismës “Panair për të rinjtë në çdo qark”, përgjatë këtij muaji Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ka organizuar tre panaire për edukim, trajnim dhe punësim në qytetin e Vlorës, Shkodrës dhe Tiranës me qëllim fuqizimin, informimin dhe zhvillimin akademik e profesional të të rinjve dhe lehtësimin e kalimit nga shkolla në tregun e punës. **Mbi 60 institucione, biznese e organizata njohën të rinjtë me mundësitë që ata ofrojnë në qytetet respektive, por jo vetëm. U njohën edhe me mundësi e programe kombëtare në përputhje me qëllimet dhe profesionet e të rinjve dhe kërkesat e tregut të punës.** Panairët janë mirëpritur nga të rinjtë në çdo qytet, dhe kjo nismë do të vijojë edhe në qarqet e tjera, me qëllim afrimin e të rinjve me ofruesit e shërbimeve për të rinj, duke pasur përfaqësi nga universitetet, bizneset lokale dhe kombëtare, institucionet shtetërore si ministri linje, apo agjenci zbatuese për programe lidhur me të rinjtë, dhe organizatat e shoqërisë civile që mbështeten nga Agjencia Kombëtare e Rinisë. Institucionet dhe përgaqësuesit në panaire rriten më shumë me çdo qytet, duke treguar se angazhimi i të rinjve është i nevojshëm në çdo nivel.



FORUMI RINOR I BALLKANIT PERËNDIMOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, në statusin e përfaqësueses së Qeverisë Shqiptare në Zyrën Rajonale për Bashkëpunim Rinor, që këtë vit kryesohet nga Shqipëria, në bashkëpunim me këtë të fundit, çelën më datë 6 tetor, "Forum Rinor të Ballkanit Perëndimor". Me pjesëmarrjen e 90 të rinjve që fuqizojnë zërin e bashkëmoshtarëve të tyre në të gjithë Ballkanin Perëndimor, duke qenë aktorë kryesorë që sugjerojnë dhe ndërveprojnë për zhvillimin e qëndrueshëm dhe procesin e integritit të rajonit në BE, u zhvilluan një sërë diskutimesh në "Balkan Youth Express", rrugëtimi me tren nga Elbasani në Durrës, rreth demokracisë, paqes dhe sigurisë gjithëpërfshirëse, dhe jetesës së qëndrueshme ku u diskutuan mënyrat efektive dhe afatgjata që mund të ndërmerren për të forcuar secilën prej komponentëve dhe cilësinë e jetesës së të rinjve në të gjithë Ballkanin Perëndimor. **Diskutimet i paraprindë deklarates së "Forumit Rinor të Ballkanit Perëndimor 2023", e cila u përmbyll më 7 tetor dhe u paraqit në Samitin e Liderave të Procesit të Berlinit më 16 Tetor.**



BRUKSEL – LANÇIMI I INDEKSIT TË PROGRESIT RINOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët me ftesë të Forumit Rinor të Bashkimit Evropian iu bashkua eventit të lançimit të Indeksit të Progresit Rinor, ku përveç se evidentoi politikat dhe masat e ndërmarra nga qeveria me qëllim zgjerimin e ofertës së shërbimeve dhe mbështetjes për të rinjtë, evidentoi edhe mënyrën e politikëbërjes për fushën e rinisë, ku të rinjtë janë pjesë e vendimmarrjes aktive duke përcjellë kërkesat dhe zërat e bashkëmoshtarëve me anë të Këshillave Vendorë Rinorë dhe Këshillit Kombëtar Rinor. Indeksi i Progresit Rinor i përgatitur nga Forumi Rinor i Bashkimit Evropian evidentoi se në një kohë ku progresi në fushën e rinisë është i ngjirë edhe në vende më të zhvilluara, Shqipëria vlerësohet pozitivisht për fuqizimin e të rinjve, ofrimin e shërbimeve me standarde të larta dhe mundësive që krijohen ditë pas dite për të rinjtë në përputhje me kërkesat e tyre dhe tregun e punës. **Për ecurinë në fushën e rinisë, Shqipëria u vlerësua me 74.3 pikë nga 100 në total, u vlerësua si një nga 3 vendet me progresin më të lartë në botë në 12 vitet e fundit, dhe u ngjiti me 8 pozicione në rankimin botëror për 150+ shtete.**



GJENEVË – KONFERENCA E 30-TË NDËRKOMBËTARE: "POPULLSIA DHE ZHVILLIMI: SIGURIMI I TË DREJTAVE DHE ZGJEDHJEVE"



Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët drejtoi delegacionin Shqiptar në Konferencën Ndërkombëtare: "Popullsia dhe Zhvillimi: Sigurimi i të drejtave dhe zgjedhjeve" (ICPD 30), në selinë e OKB-së në Gjenevë, organizuar nga UNFPA dhe UNECE, ku prezantoi një pjesë të punës intensive në përmbushjen e angazhimeve të marra në ICPD25, duke përfshirë miratimin dhe zbatimin me sukses të Ligjit "Për Rininë"; skemën e re të financimit për OSHC-të dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore në përputhje me kriteret e OKB-së dhe BE-së, miratimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029; integrimin e njohurive mbi shëndetin seksual, riprodhues dhe ndërgjegjësimin ndaj substancave si pjesë e kurrikulave gjithëpërfshirëse; ngritjen e mekanizmave në nivel qendror dhe lokal për të luftuar dhunën me bazë gjinore; dhe miratimin e Regjistrimit Kombëtar për të Dënuarit për Krime Seksuale. Në panelin e parë mbi demografinë dhe demokracinë, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët prezantoi politikëbërjen e Shqipërisë për të rinjtë dhe evidentoi përparimin që ka bërë Shqipëria ndaj angazhimeve të ICPD 25 për angazhimin, pjesëmarrjen dhe fuqizimin e të rinjve, duke theksuar angazhimin e të rinjve në hartimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029, metodologji e vlerësuar pozitivisht dhe konsideruar si një shembull me vlerë për t'u ndjekur nga shtete të tjera, në mënyrë që strategjitë dhe politikat që ndërmerren për të rinjtë, të jenë gjithmonë në përputhje me nevojat e të rinjve.

MBAHEN TAKIME ME KËSHILLIN VENDOR RINOR DHE TË RINJTË E QYTETIT TË LIBRAZHIDIT

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët zhvilloi një takim me Këshillin Vendor Rinor të Librazhdit, Kryetarin e Bashkisë, njëkohësisht dhe kryetar i KVR Librazhd, si dhe me anëtarët e Këshillit Bashkiak ku diskutuan rreth çështjeve që shqetësojnë të rinjtë e qytetit dhe planet për zgjidhjen efektive dhe afatgjatë të tyre. Bashkëpunimi i këtyre tre strukturave me njëra-tjetrën për të përcjellë zërin e të rinjve të qytetit, duke e sjellë aktivizmin e tyre në një formë ndryshe, angazhim për një të ardhme më të mirë për qytetin dhe realizimin e nevojave të të rinjve, po jep rezultate pozitive, evidentuar kjo në takimin e Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët me të rinjtë e qytetit në palestën e re të gjimnazit "Ibrahim Muça". Përgjatë bisedës, të rinjtë jo vetëm treguan për ecurinë e tyre mësimore dhe si e shohin veten në vitin e ri shkollor, por edhe parashtuan kërkesat e tyre për përmirësimin e jetës në qytet. **Të rinjtë parashtuan të njëjtat kërkesa si Këshilli Vendor Rinor Librazhd, duke evidentuar kështu që KVR Librazhd po bën një punë shumë cilësore për fuqizimin e zërit të të rinjve, në përputhje kjo me qëllimin e parë të Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029.**



FINALIZOHET EDICIONI I DYTË I PROJEKTIT "WE ARE ALL MADE OF STARS", FINANCUAR NGA THIRRJA E DYTË E AGJENCISË KOMBËTARE TË RINISË

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët mori pjesë në eventin përmbyllës të projektit "We are all made of stars 2", financuar nga Thirrja e Dytë për projekt-propozime nga organizatat rinore dhe/ ose për të rinjtë të Agjencisë Kombëtare të Rinisë. Performanca muzikore, kërcime popullore dhe moderne, poezi dhe humor nga të rinjtë e talentuar karakterizuan eventin final të projektit "We are all made of stars 2", i zbatuar në 5 qytete të Shqipërisë, Elbasan, Tiranë, Durrës, Lezhë dhe Shkodër, për 9 muaj, me pjesëmarrjen e 200 të rinjve që kanë zhvilluar kurse pa pagesë për kërcim, këndim, teatër dhe aktrim, finalizuar këto me një mbrëmje gala në Teatrin e Operas dhe Baletit. Projekti zhvillohet në kuadër të qëllimit të parë të Strategjië Kombëtare të Rinisë 2022-2029 për fuqizimin e të rinjve dhe pjesëmarrjen e tyre aktive në shoqëri.



LANÇIMI I FONDIT KULTUROR PËR TË RINJË E BALLKANIT PERËNDIMOR

Më datë 7 tetor, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët në bashkëpunim me Zyrën Rajonale për Bashkëpunim Rinor dhe me mbështetje financiare nga Qeveria Gjermane lançuan një nismë të re, atë të Fondit Kulturor të Rinisë të Ballkanit Perëndimor, i cili përveç mbështetjes për organizatat rinore të orientuara drejt fushës së kulturë, mbështet edhe aktivizmin kulturor të të rinjve dhe zgjidhjet kreative për çështje sociale dhe politike në Ballkanin Perëndimor, duke përfunduar bashkëpunimin kulturor brenda rajonit. **Fondi Kulturor i Rinisë do të ketë deri në 10 thirrje të hapura deri në vitin 2026 dhe do të mbështesë financiarisht projekt-ide të të rinjve deri në vlerën 3000 euro dhe deri në 6000 euro për organizatat rinore.**